



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 20 mars 2012

Numri i lëndës 2011-21

Z. Vektor Maznikolli

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 20 mars 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregulloren e Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 18 qershor 2011.

II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve që janë në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

3. Më 21 nëntor 2003, prokurori i qarkut ngriti një aktakuzë kundër parashtruesit të ankesës duke ngarkuar atë me akuzë penale për vrasje, lëndim të lehtë trupor dhe posedim joligjor të armëve dhe municionit që pretendohet të jenë kryer me 23 gusht 2003 në Pejë.
4. Më 28 janar 2004, parashtruesi i ankesës u lirua nga akuza për vrasje dhe u dënua lidhur me kundërvajtjet e tjera me gjashtë (6) muaj burg.
5. Më 27 janar 2005, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë lirimin e tij nga akuza dhe sa i përket akuzës për vrasje e kthej rastin për rigjykim në instancën e parë.
6. Më 8 maj 2007 u zhvillu rigjykimi dhe parashtruesi i ankesës u lirua prapë nga akuza, pasi gjykata konstatoj se vrasja ishte kryer në vetëmbrojtje të nevojshme.
7. Më 6 dhjetor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë edhe një herë lirimin nga akuza dhe rikthej rastin në gjykatën e instancës së parë për rigjykim.
8. Më 28 dhjetor 2009, kryetari i Gjykatës së Qarkut të Pejës parashtroj një kërkesë tek EULEX-i që EULEX-i ta merrte lëndën përsipër. Kërkesa ishte pranuar më 21 janar 2010.
9. Më 23 korrik 2010, Gjykata e Qarkut të Pejës kishte shpallur parashtruesin e ankesës fajtor për vrasje të provokuar, të kryer më 23 gusht 2003 në Pejë. Ai u dënua me tetë (8) vite në burg.
10. Parashtruesi i ankesës e apeloj këtë vendim tek Gjykata Supreme e Kosovës më 15 tetor 2010. Në kohën e paraqitjes së kësaj ankese, ai gjendej në burgun e Dubravës.

III. ANKESAT

11. Parashtruesi i ankesës kërkon që të mbahet një seancë lidhur me ankimimin e tij pranë Gjykatës Supreme sa më shpejt që është e mundur. Ai konstaton se për shkak të vonesës, të drejtat e tij themelore dhe të drejtat e tij si i burgosur janë shkelur.

IV. LIGJI

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
13. Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të

mandatit të tij ekzekutiv, siç përcaktohen në Rregullën 25, paragrafin 1 të Rregullores së vet të Punës.

14. Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës në thelb kërkon që Paneli të ndërmerr masa në mënyrë që të përshpejtoj procedurat lidhur me lëndën e tij, e cila është e pazgjdhur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.
15. Paneli nuk ka kompetencë as mbi fushën administrative e as mbi fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ketë ndikim në renditjen dhe në përshpejtimin e shqyrtimit të ankesave, të cilat janë të pazgjdhura nga Gjykata Supreme. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të Gjykatës Supreme, të cilët janë të caktuar për shqyrtimin e lëndës, nuk do të thotë se ia humb Gjykatës Supreme karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës. (Shih, midis të tjerash, edhe lëndët nr. 2011-24, *Predrag Lazic*, paragrafi 20; 2011-10, *Dejan Jovanovic*, paragrafi 33.)
16. Si rezultat, kjo çështje që është ngritur në këtë ankesë nuk bie brenda kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.
17. Përpos kësaj, Paneli konstaton se më 2 gusht 2011, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga parashtruesi i ankesës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, ankesa është e pabazuar, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit